



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPSTINA-STIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

02 Nr. 510

Dt. 25.10.2021

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 neni 13 dhe neni 58 pika d, neni 10, Ligjit nr 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr 03/L-205, nenit 83 të Ligjit nr. 05/L- 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimit të Kuvendit Komunal – Shtime Npi 01/203 datë 14.07.2021, Kryetari i Komunës mori këtë:

**V E N D I M - P R E L I M I N A R**

1. **Aprovohet** kërkesa e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi e Komunës së Shtimes, për shpronësimin e patundshmërisë për interes publik dhe atë ngastrave kadastrale me nr. P-72809093-01397-16 në sipërfaqe prej 8625 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale – Shtime, të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilët preken nga zgjerimi i Zonës industriale sipas tabelës të bashkangjitur të këtij vendimi.

2. **Obligohet** Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Sektori për çështje pronësore-juridike që brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi – preliminar, të njoftoj pronarët e pronës së patundshme dhe zotëruesit e interesit e cila do të shpronësohet dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas aprovimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

3. Kundër këtij vendimi apo cilëndo pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronarë, apo zotërues i interesit në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Sektori për çështje pronësore-juridike dhe Zyra Kryesore Financiare (ZKF).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Kryetari i Komunës:  
Naim Ismajli

**Iu dërgohet:**

- Palës
- Zyrës Kryesore Financiare
- Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
- Arhives.

**Tabela mbi shpronësimin në bazë të vendimit Preliminarë nr 02 nr. 510 datë 25.10.2021**

<b>Komuna Shtime – Zona Kadastrale –Shtime</b>							
<b>Nr</b>	<b>Pronarë</b>	<b>Nr.i ngastrës</b>	<b>Kultura -klasa</b>	<b>Sipërfaqja e përgjithshme m<sup>2</sup></b>	<b>Sipërfaqja për shpronësim m<sup>2</sup></b>	<b>Sipërfaqja e mbetur m<sup>2</sup></b>	<b>Vërejtje</b>
1	<b>Xhafer (Haki) Hysaj Nga Shtimja</b>	<b>P-72809093-01397-16</b>	<b>Tokë pyjore (mal-2)</b>	<b>8625</b>	<b>8625</b>	<b>00</b>	